



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1475/1 Prot.

Tiranë, më 23 / 10 / 2018

### V E N D I M

#### **Nr. 218, Datë 23 / 10 / 2018**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr. 108, datë 19.07.2018, të bërë nga TH.B, kundër Administratores se Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” sh.a Gjirokastër, me pretendimin për diskriminim për shkak të “etnisë<sup>1</sup>”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I :

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash deklaroi se: “Pas emërimit të administratores, në ndërrmarrje filloi menjëherë penalizimi dhe diskriminimi ndaj TH.B, pasi: - E ka caktuar të punojë jashtë orarit zyrtar të punës; - Nuk i paguan detyrimet për largësinë e punës nga vendbanimi 30 km larg (neni 3 i kontratës); - E ka caktuar me detyra të tjera pa urdhër me shkrim, si psh (të bëjë rojen deri në orët e vona duke e ditur që vendbanimi është larg dhe në atë orar nuk ka transport publik); - E ka imponuar për dorëheqje pasi ka deklaruar në zyrën e saj, duke i thënë që do vendosë vijë të verdhë nga Derviciani e lart (fshat minoritar Grek, ku përfshihet dhe vendbanimi i ankuesit). Për të gjitha sa më sipër TH.B me anë të tri shkresave i ka kërkuar administratores respektimin e legjislacionit në fuqi mbi rregullimin e marrëdhënive të punës për punonjës që kanë vendbanimin mbi 25 km larg vendit të punës”.

<sup>1</sup> Referuar informacionit të dërguar në datë 23.08.2018, Th.B është me kombësi Greke bazuar në kartën e identitetit AI 811302.  
- Referuar Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës. ECRI Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 “Diskriminim racial është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preference që bazohet se shkaqe si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, që justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit për shkak të etnisë.

Ankesa e sjellë pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale, lidhur me shpjegimet e dhëna prej subjektit ankues, në lidhje me shkakun e pretenduar dhe lidhjes shkakësore për trajtimin më pak të favorshëm.

- Për këtë arsye, me e-mail-in datë 20.07.2018, inspektori i çështjes, i ka kërkuar ankuesit të paraqesë shpjegime të trajtimit të pabarabartë në raport me punonjësit e tjerë për shkaqet e pretenduara, meqenëse subjekti ankues nuk ka parashtruar argumentime lidhur me këtë fakt dhe nuk ka identifikuar një krahasues.
- Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, ankuesi me emailin datë 23.08.2018 ka dërguar pranë Komisionerit informacion shtesë lidhur me pretendimet, kartën e identitetit të kombësisë Greke dhe kopje të Urdhërit nr.221, datë 06.08.2018 mbi zgjidhjen e menjëhershme të kontratës për punonjësin Th.B.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së<sup>2</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

<sup>2</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- A. Me shkresën nr. 1034/1, datë 25.07.2018 është njoftuar Shoqëria “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastër dhe i është kërkuar informacion lidhur me pretendimet e ngritura nga shtetasi Th.B.
- B. Me shkresën, Kujtesë nr.1034/2, datë 31.08.2018 është njoftuar përsëri Shoqëria “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastër për pretendimet e subjektit ankues.

Me shkresën nr. 253, datë 10.09.2018 Shoqëria “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastër, informon Komisionerin se: *“D.D, në datë 21.11.2017 është caktuar në detyrën si Administratore e shoqërisë “Trajtimi i studentëve” dhe menjëherë ka konstatuar se shoqëria ka patur rezultate në humbje dhe për këtë i është dashur të bëjë organizimin e ri të punës. Në datë 13.12.2017 nga ana e kujdestarit Th.B i është bërë ankim për dëmtime materiale në mënyrë të përsëritur nga ana e studentëve. Për këtë arsye, në konviktin e djemve ka organizuar punën me dy kujdestarë, nga një kujdestar që ishte më përpara. Legjislacioni shqiptar nuk parashikon mbulimin e shpenzimeve të transportit për punonjësit që vendbanimin e kanë në distanca të largëta, por shoqëria bazuar në pikën 3 të VKM nr.68, datë 7.2.2018 ka qenë në gjendje që të sigurojë fjetjen në ambientet e shoqërisë për Th.B. Që në fillim të vitit 2018 kur ka filluar organizimi i punës me dy turne dhe për kujdestarët e konviktit të djemve, Th.B është trajtuar me të njëjtat të drejta ashtu si dhe kujdestari tjetër dhe në asnjë rast nuk i është kërkuar ankuesit kryerja e orëve shtesë. Në kontratën e punës të lidhur me Th.B nuk është parashikuar shpërblim për largësinë nga vendi i punës. Në lidhje me orarin e punës të Th.B, shoqëria ka marrë në konsideratë kërkesën e ankuesit dhe vërtet për të është bërë ndryshim orari, krahasuar me kujdestarin tjetër i cili në turnin e paradites e merr punën në orën 07.00, ndërsa Th.B e merr punën në orën 8.00. Pretendimi i ankuesit në lidhje me etninë nuk është i vërtetë pasi në asnjë moment nuk i është përmendur etnia apo besimi i tij. Nga puna janë larguar ata persona të cilët janë njoftuar sipas Kodit të Punës përpara zgjidhjes së kontratës ose në kushtet e shkeljes flagrante. Organizimi i punës për vitin 2018 ka bërë që në institucion të punësohen dhe 7 persona, 4 prej të cilëve janë të besimit ortodoks dhe 3 të besimit musliman, gjë që tregon se nga ana e drejtueses së institucionit nuk rezulton diskriminim për asnjë lloj etnie. Nga ana e Th.B ka pasur në mënyrë të vazhdueshme mungesë korrektesie për disiplinën orare të punës, në të dy turnet. Me shkresën nr.46, datë 15.02.2018, Th.B ka marrë masë disiplinore “Paralajmërim për pushim nga puna” për arsye të mos respektimit të orarit zyrtar të punës. Po ashtu me Urdhrin nr.219, datë 06.08.2018 Th.B i është dhënë masa disiplinore “Paralajmërim për pushim nga puna” në zbatim të Urdhrit nr.217, datë 30.07.2018 “Për përfundimin e inspektimit financiar publik” të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë në të cilin është urdhëruar marrja e masave disiplinore për punonjësit G.Ç dhe Th.B për mos respektim të rregullave të prokurimit publik”.*

- C. Me shkresën nr.1034/4, datë 15.10.2018 është kërkuar informacion nga Shoqëria “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastër lidhur me masat disiplinore të punonjëses G.Ç.

Me shkresën nr. 289, datë 19.10.2018 Shoqëria “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastër, informon Komisionerin se, punonjësja G.Ç gjatë dy viteve të fundit ka pasur një masë disiplinore “Paralajmërim për pushim nga puna” me nr.222, datë 06.08.2018 në zbatim të Urdhrit nr.217, datë 30.07.2018 të Ministrit të Financave.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të administruara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm të ankuesit nga Shoqëria “Trajtimi i studentëve” Gjirokastër.**

Nga këqyrja e dokumentacionit të depozituar pranë KMD-së, rezulton se, Th.B ka filluar punë pranë Shoqërisë “Trajtimi i studentëve” Gjirokastër, në muajin Nëntor 2013 në pozicionin si kujdestar, dhe në datë 03.01.2018 mes tij dhe Shoqërisë “Trajtimi i studentëve” Gjirokastër është nënshkruar kontrata individuale e punës, pa afat në degën e shërbimit, në pozicionin si kujdestar në konviktin e djemve. Me shkresën nr.46, datë 15.02.2018 të Administratores së shoqërisë është vendosur dhënia e masës disiplinore “Paralajmërim për pushim nga puna” për arsye të shkeljeve të njëpasnjëshme të orarit zyrtar të punës nga ana e Th.B, të evidentuara<sup>3</sup> nga përgjegjësja e personelit. Me Urdhrit nr.217, datë 30.07.2018 “Për përfundimin e inspektimit financiar publik”, Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka urdhëruar marrjen e masës disiplinore “Paralajmërim për largim nga puna” për punonjësit G.Ç dhe Th.B për mos respektim të rregullave të prokurimit publik. Me shkresat nr.219 dhe nr.222, datë 06.08.2018, Administratorja e shoqërisë bazuar në urdhrin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Paralajmërim për pushim nga puna” për punonjësin Th.B dhe G.Ç, ndërsa me shkresën nr.221, datë 06.08.2018 ka vendosur zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës për punonjësin Th.B për arsye të masave disiplinore të përsëritura<sup>4</sup>.

Në Rregulloren e Brendshme të shoqërisë “Trajtimi i studentëve” Gjirokastër të miratuar me Vendimin nr.74, datë 18.05.2015 përcaktohet se: *“Administratori i shoqërisë që është Drejtori, emërohet nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë. Ai drejton shoqërinë e Trajtimit të Studentëve sh.a Gjirokastër duke u mbështetur në ligjet përkatëse si në aspektin financiar ashtu dhe në probleme të ndryshme që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e punëve nëpër konvikte për studentët dhe personelin e shoqërisë”*.

Referuar në sa më sipër, vlerësohet se administratori i shoqërisë është personi i ngarkuar për organizimin e punës në shoqëri dhe bazuar në këtë kompetencë, administratori ka drejtuar procesin e organizimit të shoqërisë dhe lidhjes së kontratave të reja me punëmarrësit.

Referuar informacionit të vënë në dispozicion nga palët rezulton se D.D në datë 21.11.2017 është emëruar në pozicionin si Administratore e shoqërisë “Trajtimi i studentëve” Gjirokastër. Në datë 03.01.2018 është lidhur kontrata e punës mes Th.B dhe Shoqërisë “Trajtimi i studentëve”

<sup>3</sup> Proces verbal datë 12.02.2018, 13.02.2018 dhe 14.02.2018.

<sup>4</sup> Masa disiplinore “Paralajmërim për pushim nga puna” datë 15.02.2018 dhe datë 06.08.2018.

Gjirokastrë. Në nenin 3 të kësaj kontrate shkruhet se: *“Pranimi në punë do bëhet sipas dokumenteve që tregohen për pranimet në punë dhe që provojnë aftësinë profesionale, kualifikimin dhe vendbanimin e punëmarrësit”*.

Në pikën 3 të VKM-s nr.68, datë 07.02.2018 *“Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”* përcaktohet se: *“Punëdhënësi është i detyruar t’i sigurojë strehim punëmarrësit, në kushtet kur ky i fundit nuk ka mundësi të kthehet në vendbanimin e tij për shkak të largësisë së vendit të punës me qendrën e vendbanimit”*.

Bazuar në legjislacionin e sipërcituar dhe informacioneve të dhëna nga palët, vlerësohet se nga ana Th.B janë pranuar termat e kësaj kontrate dhe në kontratë nuk është parashikuar ndonjë detyrim ligjor lidhur me detyrimet e punëdhënësit për shpërblimin e punëmarrësit për transportin nga vendbanimi në vendndodhjen e punës, por referuar legjislacionit të sipërcituar, punëdhënësi është i detyruar t’i sigurojë punëmarrësit strehim kur nuk është në gjendje të kthehet në vendbanimin e tij. Në këto kushte, Th.B është përfitues i këtij parashikimi dhe bazuar në informacionin e dhënë nga Administratorja e shoqërisë dhe duke pasur parasysh mundësitë reale të shoqërisë, ky shërbim i është ofruar Th.B.

Referuar informacionit të deklaruar nga palët, nuk u arrit që të provohej se Th.B të jetë urdhëruar apo detyruar të kryejë detyra të tjera jashtë kushteve të kontratës dhe kërkesat<sup>5</sup> e tij drejtuar drejtuesve të institucionit kanë marrë përgjigje nëpërmjet shkresës nr.181, datë 11.06.2018 të Administratores së shoqërisë.

Në lidhje me dhënien e masave disiplinore në drejtim të Th.B, Komisioneri vlerëson se dhënia e masave disiplinore është në tagrin e Administratores së shoqërisë dhe nga ana e punëdhënësit është e provuar thyerja e disiplinës së punës nga Th.B i cili nuk ka ndërmarrë hapa për të kundërshtuar<sup>6</sup> masën disiplinore të dhënë në datë 15.02.2018.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe ofron mbrojtje për një listë jo shteruese shkaqesh. Gjithashtu në nenin 12, pika 1, germa b) parashikon se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur*

---

<sup>5</sup> Kërkesa datë 24.03.2018 dhe dy kërkesa datë 03.05.2018.

<sup>6</sup> Në nenin 203/1 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë shkruhet: *“... Afati i parashkrimit për masën disiplinore është një vit, nga momenti i marrjes së masës disiplinore, njoftuar me shkrim punëmarrësit”*.

*në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në nenin 3/2 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Nga dokumentet e administruara gjatë trajtimit të ankesës, dhe shpjegimet e dhëna nga Shoqëria “Trajtimi i studentëve” Gjirokastër, lidhur me pretendimin për diskriminim për shkak të etnisë, vlerësohet se nuk rezulton i provuar fakti që Th.B të jetë trajtuar në mënyrë të pabarabartë nga ana e Shoqërisë “Trajtimi i studentëve” Gjirokastër, dhe se vendimmarrja për trajtimin e tij në vendin e punës sipas termave të kontratës, të jetë paragjykuar, ndikuar, direkt apo indirekt, për shkak të etnisë së Th.B.

Shoqëria “Trajtimi i studentëve” Gjirokastër argumenton dhe provon se largimi nga puna i Th.B është bërë vetëm për shkaqe ligjore dhe për asnjë motiv tjetër, dhe për këtë ka paraqitur një kopje të Urdhrit nr.217, datë 30.07.2018 “Për përfundimin e inspektimit financiar publik”, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me nr.10187/9, datë 30.07.2018 në të cilin në pikën 1 të tij, urdhërohet marrja e masës disiplinore “Paralajmërim me largim nga puna” për punonjësit Th.B dhe G.Ç.

Pra përfundimisht, nga gjithë sa rezultoi më lart, vlerësohet se masa e dytë disiplinore për Th.B ka ardhur si rrjedhojë e një konstatimi të një institucioni tjetër të specializuar në kontrollin financiar dhe zgjidhja e menjëhershme<sup>7</sup> e kontratës së punës së ankuesit është bërë për shkaqe të mbështetura ligjore dhe të argumentuara në prova dhe dokumente ligjore.

---

<sup>7</sup> Në nenin 153/3 të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë shkruhet: “Gjykata vendos nëse ekzistojnë shkaqe të justifikuarra për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës. Konsiderohen shkaqe të justifikuarra rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimin me shkrim të punëdhënësit”.



Në përfundim, për sa më sipër, në mungesë të trajtimit të pabarabartë dhe disfavorizues të ankuesit nuk ndodhemi në kushtet e diskriminimit për shkakun e pretenduar nga Th.B, nga ana e Administratorit të Shoqërisë “Trajtimi i studentëve” Gjirokastrë.

Lidhur me pretendimin e Th.B për diskriminim të tij, për shkak të etnisë, nga ana e Administratores se Shoqërisë “Trajtimi i studentëve” Gjirokastrë, ku theksohet fakti se e ka imponuar për dorëheqje duke i thënë që do vendosë vijë të verdhë nga Derviciani e lart, Komisioneri gjykon se ankuesi nuk e ka provuar me fakte dhe prova konkrete, që sjellje të tilla ofenduese kanë ndodhur.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit Th.B nga ana e Shoqërisë “Trajtimi i studentëve” Gjirokastrë, për shkak të etnisë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(shkaku: etnia)  
(fusha: punesim)